

VENDIM
Nr. 77, datë 30.1.2013

**PËR MIRATIMIN E “RREGULLIT TEKNIK PËR KËRKESAT THELBËSORE DHE VLERËSIMIN
E KONFORMITETIT TË INSTRUMENTEVE TË PESHIMIT JOAUTOMATIK”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 10 480, datë 17.11.2011 “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore” dhe të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr. 10 489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit e Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e “Rregullit teknik për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të instrumenteve të peshimit joautomatik”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.¹
2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

¹ Ky akt nënligjor është përafruar plotësisht me direktivën 2009/23/ EEC e Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 23 prill 2009 për instrumentet e peshimit joautomatik. Numri Celex: 32009L0023, botuar në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Europian, seria L, nr. 122, datë 6 maj 2009, faqe 6-26 (OJ L 122, 16 May 2009, p. 6-26)